



Tetor, 2021 Nr.10

ZGJEDHJET LOKALE 2021

Shpallur raporti i dytë nga informimi i monitorimit para fillimit të kampanjës zgjedhore

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale më 1 tetor e shpalli raportin e dytë nga monitorimi i informimit të mediave për Zgjedhjet lokale për periudhën para fillimit të kampanjës zgjedhore (nga 1 deri 26 shtator 2021). Në raport është analizuar 24- orëshi i programeve në MRT 1 dhe të gjashtë televizioneve komerciale në nivel shtetëror – TV 24 Vesti, TVAlsat-M, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Sitel dhe TV Telma. Rezultatet nga monitorimi treguan se gjatë kësaj periudhe nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave të Kodit zgjedhor. Në periudhën parazgjedhore tek MRT 1 nuk janë evidentuar ballafaqime debatuese të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, ku shërbimi publik i transmetuesve është i obliguar ti organizojë sipas nenit 76-a paragrafi 11 nga Kodi zgjedhor. Obligimin për njoftimin në gjuhën e shenjave për personat me dëmtim të dëgjimit, e përbushën në veçanti MRT 1 dhe TV 24 Vesti.

Tema për zjarrin fatal në spitalin modular Kovid-qëndër në Tetovë i mbuloi të gjitha aktualitetet, politikat e brëndshme dhe temat shoqërore nga ngjarja tragjike e 8 shtatorit dhe më tej. Gjithnjë e më shumë redaksitë informuese vendosën periudhën parazgjedhore ta plotësojnë me intervista, skica mediatike të kandidatëve për kryetar komune, me apostrof për dymbëdhjetë partiak, dhe opione të pavarura për kryetar komune të Shkupit. Pjesa më madhe e përmbajtjeve mediatike ishte e preokupuar me rivalitetet partiake shumëvjeçare, dhe shpesh herë të personalizuar si përplasje të liderëve partiak, dhe kthesa gazetareske ndaj politizimit jokonstruktiv në të gjitha sferat e shoqërisë, e relativizuan, gjegjësisht e bën dykuptimëshe dhe përmbajtjen e lajmeve dhe të raporteve. Raportet veçmas për shërbimet programore nacionale që ishin mjet të monitorimit janë përmbledhur në raportin e dytë të informimit të mediatik për Zgjedhjet lokale, në dispozicion në linkun e radhës [линк](#).

Lajmërime për publikun

Më 7 tetor Agjencia nëpërmjet lajmërimeve informonte që gjatë monitorimit të prezantimit të mediave zgjedhore është konstatuar se shumë televizione emetonin reklamim të paguar politik ku pjesëmarrës janë minorenët. Në lajmërim ishte cekur që në përpuethshmëri me Kodin zgjedhor pjesëmarrës në kampanjë zgjedhore është përgjegjës për përmbajtjen e njoftimeve, lajmërimeve, reklamave dhe materialeve të tjera të inçizuar që porositës është, por përgjegjësi kanë dhe transmetuesit duke pasur parasysh nenin 76 paragrafi 3 nga Kodi zgjedhor, ku në mënyrë decide është përshkruar se nuk lejohet pjesëmarrja e minorenëve në reklamim të paguar politik.

Agjencioni në të dyja raundet zgjedhore nëpërmjet lajmërimeve për publikun i përkujtoi transmetuesit që në përpuethshmëri me Kodin zgjedhor, rezultatet nga ekzaminimi i mendimit publik në lidhje me Zgjedhjet lokale 2021, mund të shpallen më së voni pesë ditë para datës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve – më së voni deri në ora 24 më 11 tetor për raundin e parë, gjegjësisht deri në ora 24 më 25 tetor për raundin e dytë zgjedhor. Në lajmërimet ishte theksuar se gjatë shpalljes së rezultateve nga ekzaminimi i mendimit publik lidhur me përfaqësuesit në procesin zgjedhor, institucionet kanë për detyrë të cekin të dhëna për emrin e porositësit që ka kërkuar dhe paguar ekzaminimin, institucionin që e kryen ekzaminimin, metodologjinë e përdorur, madhësinë dhe strukturën e ekzemplarit. Rezultatet nga ekzaminimi i mendimit publik të realizuara të njëjtën ditë të zgjedhjeve nuk duhet të shpallen para mbylljes së vend votimeve.

Në dy raundet zgjedhore, Agjencia përmes njoftimeve i informojë transmetuesit se nga 16 tetori, deri në ora 19:00 në 17 tetor për raundin e parë zgjedhor, dhe nga 30 tetor deri në ora 19:00 në 31 tetor për raundin e dytë, zbatohen rregullat për heshtjen zgjedhore. Në njoftim thuhet se gjatë kohës së heshtjes, mediat vazhdojnë të raportojnë për procesin zgjedhor, për ndalen të format e përfaqësimit zgjedhor mediatik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore.

Publikim i raportit për mbulimin mediatik në raundin e parë të fushatës për Zgjedhjet lokale 2021

Më 25 tetor, Agjencia publikoi raportin për mënyrën e informimit të transmetuesve në raundin e parë të fushatës zgjedhore (nga 27 shtator deri 15 tetor 2021). Monitorimi përfshinte gjithsej 13 shërbime programore-televizione komerciale nacionale Alsat-M, Alfa, Kanal 5, Sitel, Telma, 24 Vesti, 21-M, Shenja dhe Klan Maqedoni dhe kanalet programore të Shërbimit publik – MPT1, MRT2, Kanali i Kuvendit dhe Programin e parë të radios Maqedonase. Gjetjet e monitorimit treguan se gjatë kësaj periudhe nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave në Kodin zgjedhor.

Të gjitha shërbimet komerciale në nivel nacional kanë deponuar orvajtje të sigurojnë mbulim mediatik të kampanjës zgjedhore dhe të themi të gjithë, përveç se informon në emisionet ditore, për pjesëmarrësit në zgjedhje rezervon dhe më shumë për programe të veçanta informative. Kampanja nuk ishte e mbuluar në pajtueshmëri me principet për barazi për kandidatët për kryetar komune dhe proporcionalitet për kandidatët për këshilltar komune.



NEWSLETTER

Redakcitet e vëzhgonin kampanjën zgjedhore me pragmatizëm, sipas pritshmërive nga përvoja e përgjithshme politike për proceset e deritanishme zgjedhore, duke i dhënë prioritet SDSM dhe VMRO DPMNE dhe partive të tyre në koalicion, dhe jo sipas principeve të nisjes të kërkesave ligjore të renditura. Po, për konstatime ka një sërë arsyesh objektive, në këtë rast nisur nga baza – numri i imadhit të kandidatëve të konfirmuar për qytetin e Shkupit, për komunat e Shkupit individualisht por edhe për të gjitha komunat e vendit.

Shërbimi publik i transmetuesit përbush kërkesat ligjore për strukturën e emisioneve ditore, për emetimin e debateve dhe prezantimin papagës politik. Kanali Parlamentar transmeton përfaqësimin politik falas të shumë pjesëmarrësve në zgjedhje, duke shpërndarë orarin sipas dispozitave ligjore. Informacionet për personat me aftësi të kufizuar shqisore ka dhënë vetëm MRT 1 dhe TV 24 Vesti. Raportin për mënyrën e transmetuesit gjatë fushatës zgjedhore (nga 27 shtatori deri 15 tetori 2021) është në dispozicion në [link](#).

Të gjitha materialet në lidhje me monitorimin e mediave zgjedhore për zgjedhjet lokale janë të disponueshme në faqen e internetit www.avmu.mk, në banerin special „Zgjedhjet 2021“.

Deklaratë për publikun –dënimi i sulmeve ndaj gazetarëve

Më 18 tetor Agjencia dënoi qëndrimin joprofesional të kryetarit të Komisionit shtetëror zgjedhor ndaj gazetarëve në konferencën e pasdites për media të KSHZ-së të mbajtur në ditën e zgjedhjeve, dhe potencoi sebaratësit e funksioneve publike duhet të janë të vetëdijshëm për atë që thonë publikisht dhe të trgojnë nivelin më të lartë të respektit për të profesionit të gazetarit. Në të njëjtën kohë, ishin dënuar sulmet ndaj gazetarëve dhe pengimin në punën e tyre nga ana e simpatizërëve të partive politike.

Më 19 tetor, Agjencia dënoi fyerjet e shprehura publikisht të kandidatit të pavarur për kryetar bashkie për komunën e Kërçovës, Fatmir Limani drejtuar ndaj gazetares të TV 21, gjatë raportimit për zgjedhjet lokale. Në deklaratë thuhet se ishte jashtëzakonisht e rëndësishme që t'i mundësohet gazetarëve papengës dhe me siguri ti kryejnë detyrat e tyre profesionale për informimin në kohë të publikut. Në vend të nënçmimeve dhe fyerjeve duhet të tregojnë respekt për profesionin dhe dinjitetin e punonjësve të medias.

Agjencia më 22 tetor dënoi tentativën e kandidatit për kryetar bashkie të partisë Aleanca për shqiptarët në Tetovë, Vullnet Myrseli për diskriminimin e gazetares në televizionin nacional Klan, si dhe qëndrimin e papërshtatshëm i ministrit të punëve të jashtme Bujar Osmani ndaj gazetarit të të njëjtit televizion. Ishte theksuar se të gjitha, veçanërisht politikanët dhe zyrtarët publikë, duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësit që kanë për fjalën e thënë dhe për dhe qëndrimin e tij ndaj punonjësve të medias, ku roli themelor është informimi i publikut. Çdo përpjekje për të diskriminuar dhe dhe dëmtimin e reputacionit të gazetarëve është në kundërshtim me parimet e shtetit ligjor dhe çënojnë lirinë e informimit.

Të dhëna për shtrirjen e radiostacioneve dhe peshën në shikueshmërinë totale të stacioneve televizive –për tremujorin e tretë 2021

Për nevojat e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në muajin tetor u krye një sondazh për shtrirjen e radiostacioneve dhe për shikueshmërinë totale të stacioneve televizive, për tremujorin e tretë për 2021.

Të dhënat janë marrë nga sondazhet e opinionit publik dhe i referohen shtrirjes mesatare ditore dhe javore e radiostacioneve dheshikueshmërisë të televizioneve; peridha nga dita në të cilën i intervistuari ka dëgjuar radio/shikuar televizion; lloji i përmbajtjes së programit që ka dëgjuar i anketuari në radio/shikuar në televizion një ditë më parë; shikueshmërinë totale për një ditë më parë, dhe që marrin pjesë në shikueshmërinë e teritorit në të cilën çdo televizion transmeton një program dhe pjesë në shikueshmërinë totale; mbulimi mesatar dhe javor i televizioneve të huaja etj.

Të dhënat për shtrirjen e stacioneve dhe për pjesën në total të shikueshmërisë të stacioneve TV, për tremujorin e tretë të 2021, janë të disponueshme në faqen e internetit të Agjencisë në këtë link.



NEWSLETTER

Mbikëqyrje ndaj transmetuesve, mediave të shkruara dhe operatorëve të rrjeteve të komunikimit elektronik

Transmetuesit

Për respektimin e obligimeve nga Rregullorja për teknikat minimale, hapësinore, financiare dhe kushteve kadrovike për marrjen e licencës për transmetim televiziv, mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrative janë kryer ndaj Radio Tajm, Eko Radio, Radio Kometa 2000, Radio B-97, Radio 7, Radio Araçina, Televizioni Zdravkin dhe Siti televizion. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje.

Pas pranimit të ankesës nga personi fizik, është bërë mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore ndaj TV Sitel për respektimin e obligimeve për mbrojtjen e audiencës minorene. Gjatë mbikëqyrjes ishte konstatuar se transmetuesi ka vepruar në përputhje me kërkesat ligjore nga neni 50 paragrafi 3 nga LSHMAAV.

Ndaj televizionit KTV nga Kavadarci dhe Televizionit EDO nga Shkupi, është kryer kontroll i rregullt programor për të përcaktuar nëse radiodifuzerët kanë vepruar sipas masave të shqiptuara të vërejtjes publike, të drejtuara nëse ka shkelje të rregullave për emetimin e komunikimeve komerciale audiovizive- teknika të reja reklamimi. Mbikëqyrja tregoi se transmetuesit vepruan plotësisht sipas vendimeve për përcaktimin e masës vërejtje publike.

Media e shkruar

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative ndaj 20 botuesve të mediave të shkruara, me qëllim të konstatojnë nëse të gjitha të dhënat për emrin dhe adresën e selisë dhe redaksisë së medias së shkruar, të dhënat për personin përgjigjës, redaksinë, shtypëshkronjën, datën e botimit dhe ribotimit dhe numrin e kopjeve të shtypure, në përputhje me detyrimin sipas Ligjit për media. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje.

Operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik

Mbikëqyrje e rregullt programore për detyrimet që i referohen reghistrimit të shërbimeve programore në Agjencion dhe titlimin e programeve që i ritransmetojnë operatorët janë kryer ndaj operatorëve IP Systems, Inel Internacional, Kanal 16, AS KTV dhe Total TV. Nga mbikëqyrja u konstatua se operatorët kanë vepruar në përputhje me ligjin.

Për detyrimin e operatorëve të RRPKE që ritransmetojnë shërbime programore, në paketën programore që ata ofrojnë është e detyrueshme dhe falas të përfshihen shërbimet programore të shërbimit të transmetimit publik, janë kryer mbikëqyrje të rregullta programore ndaj operatorëve Neotel, Globalsat, Nafi dhe Beko, Drim Sat IPTV, Transped Tred, Inel Internacional, Infel KTV dhe Kabel-Net. Nga mbikëqyrja u konstatua se ky detyrim është plotësuar nga të gjithë operatorët.

